



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 35 regjistër (JR)
Datë 06.09.2024

Nr. 19 i vendimit
Datë 18.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 18.02.2026, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi, ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 777, datë 25.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi.

BAZA LIGJORE: Nenet 62, 63, 64, 65, 66 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 42 dhe 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet me shkrim, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 777, datë 25.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Në bazë të pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, *ex officio*.
2. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ai ka plotësuar dhe ka dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit të kryer për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
4. ILDKPKI-ja ka përcjellë në Komision raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. {***} prot., datë 27.02.2018, nëpërmjet të cilit ka bërë analizimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit me informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse, në të cilin është konkluduar se:
 1. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim pasurie ndër vite;*
 2. *Ka mungesë burimesh financiare të ligjshme dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
 3. *Nuk ka kryer fshehje pasurie;*
 4. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
5. Komisioni, në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe për t’u

njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektivit të rivlerësimit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Më datë 25.06.2024, në Komision u zhvillua seanca publike për shpalljen e vendimit për subjektin e rivlerësimit Saimir Nazifi. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 777, datë 25.06.2024, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi shqyrtoi pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin që për këtë subjekt, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë, të jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra mbi bazën e këtyre konkluzioneve:

6.1 Për kriterin e pasurisë: “[...] Në përfundim të analizës së rishikuar financiare, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, për shkak të balancës negative në shumën totale -2,098,174 lekë për të gjithë periudhën e rivlerësimit, e cila, pavarësisht pasaktësive dhe dyshimeve të ngritura nga Komisioni, arsyetuar hollësisht më sipër në këtë vendim, përbën shkak për penalizim. Në përfundim të rivlerësimit të kriterit pasuror, çmohet se subjekti ka kryer deklarime të pasakta e të pamjaftueshme në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, që sjell si pasojë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra”.

6.2 Për kriterin e kontrollit të figurës: “Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektivit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës së AKSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”.

6.3 Për kriterin e aftësive profesionale: “Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, Komisioni nuk konstaton problematika në drejtim të aftësive profesionale. Në përfundim, sipas ligjit nr. 96/2016, për subjektin është vlerësuar se: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale; (ii) ka treguar aftësi të mira organizative (iii) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale; (iv) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016”.

7. Kundër këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim¹ brenda afatit ligjor, nëpërmjet të cilit kërkon:

7.1 Pranimin e ankimit;

7.2 Ndryshimin e Vendimit nr. 777, datë 25.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas nenit 66, shkronja “b”, dhe në bazë të nenit 58, shkronja “a”, si dhe të nenit 59 të ligjit nr.

¹Ankimi datë 15.08.2024, protokolluar në Komision me nr. {***} prot.

84/2016, konfirmimin në detyrë, mua, subjektit të rivlerësimit, z. Saimir Nazifi, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë.

II. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

8. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shkaqe ankimi me natyrë procedurale. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim.

A. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

8.1 *Lidhur me depozitën dyemërore në emrin e subjektit dhe vjehrrës së tij*, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk e ka deklaruar në deklaratën e parë të vitit 2003 për shkak se nuk ishte pasuri e tij. Subjekti pretendon se Komisioni ka gabuar që nuk ka marrë në konsideratë deklaratën noteriale datë 04.06.2024 të vjehrrës së tij, e cila ka shpjeguar se depozita dyemërore ka qenë në pronësi të saj dhe të bashkëshortit të saj, dhe jo në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Subjekti shpjegon se GjEDNj-ja në rastin “Xhoxhaj kundër Shqipërisë” ka përcaktuar se shkarkimi nga detyra është një sanksion i rëndë që ndikon negativisht në jetën private të një individi, ndaj kërkon shqyrtimin e provave solide me etikën integritetin dhe kompetencën profesionale të individit. Gjithashtu subjekti sqaron se nuk do kishte kuptim fshehja e llogarisë dyemërore në bankë, kur mund të gjurmohet dhe verifikohet lehtësisht çdo lëvizje.

8.2 *Lidhur me përdorimin e apartamentit me sip. 67 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*, subjekti ka pretenduar se marrëdhënia juridike në momentin e krijimit të pasurisë ka qenë huapërdorje dhe ka zgjatur për një kohë të gjatë. Në lidhje me çmimin e pasqyruar në kontratat e blerjes, subjekti sqaron se të gjithë banorët i kanë prenotuar në vitin 2003, tek shoqëria “{***}” ShPK, por kontratat i kanë nënshkruar në vitet 2005, 2006, 2007, kur kanë hyrë në apartamente. Çmimi i kontratave ka qenë pothuajse i njëjtë, 320 euro për m² dhe për krahasim ka paraqitur kontrata të banorëve të këtij pallati. Subjekti gjithashtu sqaron se në kuptim të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, nuk kishte detyrimin për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie nga vjehri, pasi fakti i lidhjes së mëvonshme të kontratës së dhurimit që shërben edhe si shkak që e vendos një detyrim të tillë sipas ligjit, nuk duhet të çojë në hamendësime mbi konsiderimin e saj si pasuri e fshehur. Subjekti pretendon se Komisioni ka gabuar në konkluzionin se vjehri nuk justifikon me burime financiare të ligjshme shumën 21.632 euro për blerjen e apartamentit.

8.3 *Lidhur me pasurinë automjet të markës “Opel Astra”, me targë {***}*, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur mundësi financiare për ta blerë në vitin 2011 dhe si burim për financimin e këtij mjeti kanë shërbyer të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Peshkopi në shumën 1.000.000 lekë. Subjekti pretendon se pamundësia e konstatuar nga Komisioni vjen si rrjedhojë e afektimit nga depozita dyemërore e përbashkët me vjehrrën e tij, si dhe mosllogaritja e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Peshkopi. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka bërë objekt të vendimmarrjes së tij deklaratën periodike vjetore, të cilën nuk ka pasur kompetencë dhe as juridiksion për ta bërë. Sipas subjektit, Komisioni duhej të kishte objekt të verifikimit vetëm deklaratën *vetting*, e cila sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ka për qëllim verifikimin e pasurisë dhe dokumenteve justifikuese.

8.4 *Lidhur me deklarimin e gjendjes cash në vitin 2016*, në shumën 1.450.000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se, prej tij nuk është kuptuar gjendja *cash* për t'u deklaruar periodikisht për sa kohë subjekti ka deklaruar çdo vit të ardhurat e përfituara nga ana e tij dhe e personave të lidhur me të. Subjekti sqaron se, për shkak të kohës së gjatë, nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur burimit të krijimit të deklaratës periodike vjetore të vitit 2011, pasi ka kuptuar që burimi i krijimit të pasurisë është në seksionin e të ardhurave të kësaj deklarate, dhe për shkak të mosmbajtjes mend të burimit, pasi ka vendosur në mënyrë të përgjithshme të ardhurat e përfituara nga ai dhe bashkëshortja e tij.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Shqyrtimi i ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit kryhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* dhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2, dhe F, pika 2, e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, ankimi është depozituar brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë dorëzuar me ankimin akte për administrimin e tyre nga Kolegji në cilësinë e provës. Në datën 09.02.2026, subjekti i rivlerësimit ka depozituar parashtrime në lidhje me ankimin kundër vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit, nëpërmjet të cilave ka pretenduar disa shkelje procedurale³, të cilat nuk i ka ngritur në ankim. Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar [në vijim ligji nr. 49/2012], se subjekti mund të paraqesë deri 5 ditë para seancës

²"[...] *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*.

³*Subjekti ka pretenduar në parashtrime për shkelje të parimeve të kontradiktoritetit, barazisë së armëve, mungesës së arsytimit të vendimit të Komisionit, proporcionalitetit dhe sigurisë juridike.*

gjyqësore, parashtrime në të cilat argumenton vlerësimin e tij dhe shpjegon shkaqet e ankimit, por nuk mund të ngrejë shkaqe të reja ankimi. Trupi gjykues, bazuar në nenin 63, pika 1 të ligjit nr.84/2016, vlerësoi se subjekti ka humbur mundësinë për të ngritur këto shkaqe ankimi brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit të Komisionit.

11.1 Në vlerësim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pavarësisht sa më sipër, vlerësoi kryesisht se: (a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje, apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi që çështja duhet të vijojë të shqyrtohet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi nuk ndodhemi përpara kërkesave ligjore të parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.

Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit

A. Vlerësimi i kriterit të pasurisë

12. *Lidhur me depozitën dyemërore në emrin e subjektit dhe vjehrrës së tij*, subjekti i rivlerësimit pretendon se arsyeja që nuk e ka deklaruar këtë depozitë në deklaratën e parë të vitit 2003, është se nuk e ka konsideruar pasuri të tij. Si depozitimi, ashtu dhe tërheqja e saj janë bërë nga dy persona, subjekti dhe vjehrra e tij. Lidhur me mosdeklarimin e kësaj depozite, subjekti sqaron se ka plotësuar një procesverbal në ILDKPKI më 20.06.2016, ku ka sqaruar se kishte harruar ta deklaronte për arsye se nuk e konsideronte pasuri të tij. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vjehrra dhe vjehrra e tij kishin pasuri dhe të ardhura ndër vite. Subjekti sqaron se fakti që provon se kjo depozitë ka qenë e tyre rrjedh nga fakti tjetër i provuar, se menjëherë pas tërheqjes së depozitës së përbashkët, shuma është përdorur nga vjehrra për të prenotuar apartamentin me sip. 46.7 m,² në plazhin e Durrësit, kundrejt çmimit 22.500 euro, i cili është paguar nga vjehrra.

Subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur të drejtat e tij themelore për një proces të rregullt e të drejtë dhe nuk ka marrë në konsideratë deklaratën noteriale datë 04.06.2024 të vjehrrës së tij, e cila ka shpjeguar se depozita dyemërore ka qenë në pronësi të saj dhe të bashkëshortit të saj dhe jo në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Subjekti shpjegon se GjEDNj-ja në rastin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* ka përcaktuar se shkarkimi nga detyra është një sanksion i rëndë që ndikon negativisht në jetën private të një individi, ndaj kërkon shqyrtimin e provave solide për etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit. Gjithashtu subjekti sqaron se nuk do kishte kuptim fshehja e llogarisë dyemërore në bankë, kur mund të gjurmohet dhe verifikohet lehtësisht çdo lëvizje. Sa i përket pamundësisë financiare të personave tjerë të lidhur për të krijuar këto të ardhura, subjekti pretendon se ato nuk kanë shërbyer në blerjen e pasurisë që i është dhuruar bashkëshortes së subjektit, ndaj duhet të ishin jashtë objektit të vlerësimit dhe vendimit të Komisionit.

12.1 Konkluzioni e Komisionit për këtë pasuri: *“Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, nga Komisioni vlerësohet se mospërmbushja e detyrimit ligjor për deklarimin e depozitës në DPF-*

në e vitit 2003 si bashkëmbajtës i llogarisë dyemërore, e cila passjell edhe detyrimin ligjor për të vërtetuar burimet e ligjshme, detyrim të cilin subjekti nuk arriti ta përmbushë, si dhe mosdeklarimi i pakësimit të saj për shkak të mbylljes në DPV-në e vitit 2004, shoqëruar me deklaratimet kontradiktore, në disa raste të pavërteta e jo në përputhje me provat e administruara, në përpjekje për të justifikuar këto mosdeklarime, çmohen si përpjekje të subjektit për ta fshehur depozitën në DPFV-në e vitit 2003 dhe DPV-në e vitit 2004, dhe e vënë atë në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për shkak të deklaratimeve të pasakta e të pamjaftueshme, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Deklarimi i depozitës bankare në deklaratën vetting, ku nuk është deklaruar sipas ligjit burimi i të ardhurave për krijimin e saj dhe nuk janë paraqitur dokumente justifikuese për të vërtetuar burimet, çmohet se është bërë vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit dhe nuk e përjashton subjektin nga përgjegjësia ligjore”.

12.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, nuk e ka deklaruar depozitën dyemërore që kishte bashkë me vjehrrën e tij, ndërsa në deklaratën vetting subjekti ka deklaruar depozitën, duke sqaruar: *“Llogari depozitë e çelur në ish Bankën Amerikane (blerë nga Intesa Sanpaolo Bank), datë 26.12.2002, së bashku me shtetasen L. K. (vjehrra ime) në shumën 23.014 USD. Kjo llogari është mbyllur me datë 28.11.2004. Theksoj se kjo shumë ka qenë e vjehrrës time, sepse unë jam futur në këtë depozitë vetëm për të tërhequr në raste nevojë, pasi ajo banonte akoma në qytetin e Peshkopisë në atë kohë”.*

12.3 Sipas dokumentacionit në dosje, rezulton i administruar vërtetimi i lëshuar nga Intesa San Paolo Bank⁴ me datë 23.01.2017, sipas të cilit Saimir Nazifi ka pasur një llogari të përbashkët me znj. L. K. (vjehrra e tij) pranë bankës Amerikane, tek e cila më datë 26.12.2002 kanë hapur një depozitë me afat në shumën 23,014.74 USD, depozitë e cila është mbyllur më datë 26.11.2004.

12.4 Me kërkesë të Komisionit, Intesa Sanpaolo Bank, me përgjigjen e datës 16.02.2024, informon se subjekti ka pasur llogari të përbashkët me L. K., duke bashkëlidhur dokumentacionin për ecurinë e depozitave nga verifikimi i të cilit, ka rezultuar se:

- Në datën 16.07.2001, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në Intesa Sanpaolo Bank, shumën 15.000 USD, me të cilën në të njëjtën datë, është krijuar depozitë. Banka ka konfirmuar se kjo llogari ka qenë dyemërore, dhe është krijuar së bashku me znj. L. K. Në datën 26.09.2002, u shtua shuma 7.600 USD (për rritjen e depozitës me 7.600 USD, ku nga banka nuk mund të identifikohet se cili është depozituesi).

- Në datën 26.12.2002, është maturuar depozita në shumën 23.014,74 USD. Kjo shumë është riinvestuar në një depozitë dy emërore me afat 3-mujor, e cila më pas është rinovuar në vijimësi deri në datën 26.11.2004.

- Pas maturimit të depozitës në vlerën 23,351.62 USD, në datën 26.11.2004, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* shumën 23.307,54 USD.

⁴ Shkresë e Sanpaolo Bank me nr. {***} prot., datë 11.04.2016, drejtuar ILDKPKI-së.

12.5 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësorin nr. 2, lidhur me arsyet përse kjo depozitë nuk është deklaruar në vitin 2003 dhe 2004, përse është hapur bashkë me vjehrrën, si dhe burimet që kanë shërbyer për krijimin e saj. Në përgjigje të pyetjes, subjekti ka sqaruar se: *“Kjo depozitë bankare është hapur në Tiranë për arsye të mosmbajtjes së parave në shtëpi, pasi vjehri dhe vjehrra e tij jetonin të vetëm në Peshkopi në atë kohë dhe nuk donin të mbanin para gjendje në shtëpi (në vitin 2001, vjehri dhe vjehrra e subjektit kanë blerë një apartament në Tiranë)”*. Ai ka deklaruar se kjo llogari është hapur në emrin e subjektit dhe jo të bashkëshortes së tij, për arsye se vjehrra e tij nuk kishte ardhur akoma të jetonte në Tiranë, por vazhdonte të jetonte me vajzat në Peshkopi. Të gjitha veprimet e mundshme bankare që mund të nevojiteshin, do të kryheshin nga subjekti i rivlerësimit pa qenë të detyruar që bashkëshortja të udhëtonte nga Peshkopia në Tiranë. Subjekti shpjegoi se tërheqja e shumës 23.000 euro, në datën 26.11.2004, lidhej me pagesën në *cash* të këstit prej 15.000 eurosh, të cilat katër ditë më vonë, më 30.11.2004, janë paguar nga vjehri i tij për blerjen e apartamentit në Durrës.

Subjekti, në përgjigje të këtij pyetësori, nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e kësaj depozite në DIPP-të 2003 dhe pakësimin e saj në vitin 2004.

12.6 Me gjithë pretendimet e subjektit cituar në paragrafin më sipër, gjatë hetimit administrativ në Komision, ai nuk provoi me dokumentacion se tërheqja e shumës nga banka në nëntor të vitit 2004, u përdor për blerjen e apartamentit të vjehrit. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit mbeti në nivel deklarativ, pasi nuk rezultoi e provuar që shuma i është dorëzuar vjehrit nga subjekti, apo të rezultojë ndonjë pagesë e kryer prej vjehrit me dokumentacion financiar, përfshirë edhe në rrugë bankare, për çmimin e blerjes së pasurisë “apartament”, në Durrës. Komisioni ka konstatuar se subjekti ka filluar të banojë që në vitin 2004 në një apartament tjetër të blerë nga vjehri i tij në Tiranë, në vitin 2006, për të cilin nuk ka të dhëna si është bërë pagesa e çmimit të blerjes. Në këto kushte, Komisioni ka ngritur dyshimin e mundësisë së përdorimit të shumës 23.000 USD nga subjekti, të tërhequr prej tij nga llogaria dyemërore me vjehrrën, në datën 26.11.2004, për të paguar blerjen e këtij apartamenti në Tiranë.

12.7 Komisioni kreu analizën financiare për të parë mundësinë e prindërve të bashkëshortes së subjektit për të krijuar depozitën në USD në ish-Bankën Amerikane, konkretisht depozitimin e shumës 15,000 USD, në datën 16.07.2001 dhe shumës 7.600 USD, në datën 26.9.2002. Në analizën financiare, Komisioni ka konsideruar të ardhurat nga punësimi i vjehrit të subjektit si dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive, duke përfshirë edhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së. Nga kjo analizë i rezultoi se prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk kishin mundësi që për periudhën 1994 deri 16.07.2001, të mund të krijonin depozitën prej 15.000 USD për diferencën negative në shumën -5.210.382 lekë. Gjithashtu, Komisioni analizoi edhe mundësinë e prindërve të bashkëshortes për të shtuar depozitën në shumën 7.600 USD, në datën 26.09.2002, nga e cila rezultoi se nuk kishin mundësi ta shtonin këtë depozitë, në vitin 2002, për diferencën negative në shumën - 923.053 lekë.

Përveç sa më sipër, Komisioni kontrolloi edhe mundësinë e subjektit për të krijuar depozitën dhe shtesën e saj, nga e cila rezultoi se, për periudhën 1991 deri 15.07.2001, subjekti i rivlerësimit nuk mund të vendoste shumën 15.000 euro në depozitë, për diferencën negative në shumën - 1.549.243

lekë, si dhe për periudhën 15.07.2001 - 26.09.2002, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk mund të shtonte depozitën me 7.600 USD, për diferencën negative në shumën - 995.545 lekë.

12.8 Komisioni kreu verifikime në lidhje me pasurinë e blerë në Durrës nga vjehri M. K., sipas të cilave i dërgoi shkresë shoqërisë “{***}” ShPK lidhur me këtë pasuri, e cila u kthye nga shërbimi postar me shënimin mbi zarf “larguar”. Komisioni i dërgoi shkresë ASHK-së Durrës për të dërguar dosjen e plotë të kësaj pasurie dhe në shkresën kthim-përgjigje⁵, ASHK-ja informon se nga verifikimi në sistemin multifunksional, pasuria nr. {***}, është në bashkëpronësi ndërmjet L. K. (4/6 pjesë), M. N.(1/6 pjesë) dhe N. K. (1/6 pjesë).

12.9 Në vijim të sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e asaj çfarë ka rezultuar, duke i referuar si më poshtë:

- *Subjekti është përpjekur të fshehtë depozitën dyemërore me vjehrrën, të çelur prej tij në vitin 2001, kur ka qenë me detyrën e gjyqtarit, duke mos e deklaruar atë në deklaratën e parë të vitit 2003 dhe DIPP-në e vitit 2004, ndërkohë që të gjitha veprimet (depozitimet/tërheqjet) në llogarinë bankare në Intesa Sanpaolo Bank janë kryer prej tij. Ndërsa në deklaratën vetting (kur depozita nuk ka qenë më ekzistente) subjekti e ka deklaruar atë, por pa deklaruar burimin e krijimit të saj.*

- *Nuk është justifikuar me të ardhura të ligjshme të vjehërrve (dhe as të subjektit) burimi i të ardhurave për depozitimet e shumave 15,000 USD dhe 7,600 USD, përkatësisht në vitet 2001 dhe 2002.*

12.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “*Dyshimet e ngritura mbi depozitën bankare janë krejtësisht të pavërteta. Mund të ketë neglizhencë, paqartësi, keqkuptime administrative, por kurrë pronësi të fshehur për depozitën bankare.*”

- *Deklarimi në ILKPDI për vitin 2003 nuk kam pasur detyrim të kryej DPF 2003.*

- *Paratë nuk kanë qenë të miat, pavarësisht depozitës së përbashkët.*

- *Depozitimi dhe tërheqja janë kryer nga të dy personat (unë dhe vjehrra).*

- *Siç kam theksuar, emri im u vendos për arsye administrative, (nëse do të kishte nevojë për lëvizje dhe vjehri e vjehrra nuk do kishin mundësi të vinin nga Peshkopia).*

- *Në procesverbalin e mbajtur me inspektorët e ILDKPKI-së më 20.06.2016, e kam deklaruar dhe sqaruar se në fakt e kisha harruar (nuk e konsideroja fare). Vjehri dhe vjehrra, në periudhën 2001 - 2003, filluan të shesin të gjitha pasuritë që kishin në Peshkopi.*

- *Është plotësisht e konfirmuar dhe e trajtuar në konstatimin nr. 2 më sipër, që menjëherë pas tërheqjes së depozitës së përbashkët, pjesa më e madhe e këtyre parave është përdorur për të prenotuar apartamentin me sip. 46.7 m² në Plazh, Durrës”.*

12.11 Subjekti i rivlerësimit, bashkë me parashtrimet mbi rezultatet e hetimit, ka dorëzuar në Komision deklaratën noteriale⁶ të vjehrrës së tij, znj. L. K., sipas së cilës ka deklaruar se depozitat dyemërore të krijuara në vitet 2002 dhe 2004 pranë ish-Bankës Amerikane, janë krijuar nga puna

⁵Shih shkresën kthim-përgjigje me nr. {***} prot, datë 13.03.2024, të dërguar nga ASHK Durrës, në dosjen e Komisionit.

⁶ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.06.2024.

e bashkëshortit të saj, M. K., si kirurg otorino-laringolog, si dhe nga puna e saj si laborante optike, e vetme në qytetin e Peshkopisë. Ajo sqaroi se paratë janë depozituar bashkë me subjektin e rivlerësimit, si person i besuar i familjes së tyre. Gjithashtu shpjegoi se paratë, pas tërheqjes nga subjekti, ia ka dorëzuar vjehrrit të tij, z. M. K.

Subjekti ka pretenduar në ankim se Komisioni ka shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk ka konsideruar vlerën e provës që ka deklarata noteriale, datë 04.06.2024. Trupi gjykues vëren se Kolegji ka mbajtur qëndrime⁷ në çështje të ndryshme, sipas të cilave deklarata noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet me dokumentacion provues.

12.12 Me parashtrimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision deklaratën noteriale⁸ të z. A. K. (nipi i vjehrrit të subjektit), të datës 06.06.2024, i cili deklaroi se, nga shitja e shtëpisë private në Peshkopi, të cilën M. K. e ka pasur në bashkëpronësi me babain e tij, secili ka përfituar nga 950,000 lekë, si dhe nga shitja e trojeve kanë përfituar nga mbi 1,000,000 lekë, por nuk disponon dokumentacion pasi veprimet janë kryer prej babait dhe xhaxhait të tij. Në vijim të qëndrimit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, edhe për këtë deklaratë noteriale, trupi gjykues, në konsideratë edhe të faktit se pretendimet në të nuk mbështeten me dokumentacion justifikues ligjor, krijoi bindjen se është hartuar në funksion të procesit të rivlerësimit, për t'i ardhur në ndihmë subjektit të rivlerësimit.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka dorëzuar në Komision një fotokopje të vendimit nr. {***}, datë 17.02.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, sipas të cilit i është njohur vjehrrit të tij një sipërfaqe toke prej 3261 m,² në emër të babait të tij, S. K. Duke iu referuar këtij dokumentacioni, të ardhurat e pretenduara nga shitja e trojeve në shumën mbi 1,000,000 lekë, sipas deklaratës noteriale të referuar në paragrafin më sipër, janë krijuar minimalisht në vitin 2009, pra shumë vite pas krijimit dhe shtimit të depozitës, për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi se kjo shumë nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e saj.

Komisioni ka vlerësuar se, edhe nëse do t'i merrej në konsideratë deklarimi i shtetasit A. K. në lidhje me të ardhurat e fituara nga shitja e pronave, do të përfshihej vetëm e ardhura e fituar nga shitja e pjesës takuese të shtëpisë private në vitin 2002, si rrjedhojë e së cilës, përsëri vjehrrit dhe vjehrra e subjektit do të rezultonin me mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e depozitës në vitin 2001 dhe shtesën e saj në vitin 2002. Pavarësisht analizës së rrethanave të krijimit të kësaj depozite, Komisioni, për efekt të analizës financiare dhe në një qëndrim garantist ndaj subjektit, vlerësoi që të konsiderojë ½ e depozitës si pasuri të subjektit dhe ½ si pasuri të vjehërrve të tij. Nga kjo analizë financiare e rishikuar në Komision, rezultoi se të dyja palët, subjekti dhe vjehrrit e tij, nuk kanë justifikuar me të ardhura të ligjshme, pjesën takuese në këtë depozitë.

⁷ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019; nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019.

⁸ Deklaratë noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 06.06.2024.

12.13 Trupi gjykues, nga dokumentacioni i administruar në dosje, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe vjehrra e tij kishin çelur depozitën dyemërore, në ish-Bankën Amerikane, më datë 16.07.2001. Këtë depozitë e kanë shtuar më datë 26.09.2002 me shumën 7.600 USD. Pas maturimit të depozitës në vlerën 23,351.62 USD, në datën 26.11.2004 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* shumën 23,307 USD, për të cilën ka deklaruar se është tërhequr me qëllim që vjehrra e tij të blinte apartamentin me sip. 46.7 m,² në Plazh, Durrës, të cilin vjehrra e ka paguar 4 ditë më vonë se tërheqja e depozitës. Nga analiza e dokumentacionit nuk rezultoi që subjekti të ketë provuar se ia ka dorëzuar këtë shumë vjehrrit të tij, si dhe nuk rezultoi e provuar se vjehrra e ka paguar shitësit shumën prej 15.000 eurosh, në rrugë bankare apo nëpërmjet një mandat arkëtimi, për blerjen e apartamentit në Durrës. Subjekti i rivlerësimit, siç është referuar edhe më sipër, vazhdimisht në Komision dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka mohuar që shumën e vendosura në depozitë të jenë të tij, duke pretenduar se ato janë të prindërve të bashkëshortes.

12.14 Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se depozita e çelur në vitin 2001 në ish-Bankën Amerikane dhe shtesa e saj në vitin 2002, janë krijuar me të ardhurat e vjehërve të tij. Për këtë qëndrim trupi gjykues mbajti në konsideratë se subjekti ka kryer personalisht vetë veprimet për çeljen e kësaj depozite, si dhe ka tërhequr gjithë shumën e maturuar në vitin 2004, duke u sjell si pronar i vetëm i kësaj pasurie likuiditet, ndërkohë që vjehrra e tij, e cila ishte bashkëmbajtëse e kësaj llogarie bankare (depozitës), nuk kishte kryer asnjë veprim lidhur me të. Gjithashtu, nuk rezultoi e provuar me dokumentacion justifikues ligjor se kjo shumë e tërhequr nga subjekti i rivlerësimit i është dhënë vjehrrit të tij, siç pretendon subjekti, me qëllim përdorimin e saj brenda pak ditësh për të paguar këstin e apartamentit që vjehrra kishte prenotuar në vitin 2004 në Durrës. Në këto rrethana, duket i pabesueshëm pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai vepronte vetëm në emër të vjehërve të tij në administrimin e kësaj depozite, pasi rezultoi se këta të fundit kishin investuar në blerjen e një pasurie në Tiranë që në vitin 1999, dhe për rrjedhojë, nuk provohet të kenë qenë objektivisht të penguar për të kryer vetë veprimet bankare. Po ashtu, duket e pakuptimtë zgjedhja e vjehërve për të depozituar kursimet e tyre në një bankë në Tiranë, larg vendbanimit të tyre, në një kohë kur, edhe sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, ata vazhdonin të jetonin në Peshkopi, e kishin mundësi t'i depozitonin këto kursime pranë një banke në atë qytet.

Trupi gjykues evidenton se deklaratimet e subjektit përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në ILDKPKI, e bëjnë të pamundur kryerjen e kontrollit nga ana e institucioneve të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri. Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklarimin e depozitës në deklarimin e pasurisë para fillimit të detyrës në vitin 2003, si bashkëmbajtës i llogarisë dyemërore, si dhe nuk ka deklaruar pakësimin e saj për shkak të mbylljes në DIPP-në e vitit 2004, e cila passjell edhe detyrimin ligjor për të deklaruar qëllimin për të cilin është përdorur. Në përfundim, lidhur me këtë depozitë, të cilën subjekti pretendon se nuk e ka krijuar me të ardhurat e tij, trupi gjykues vlerëson se veprimet bankare, të cilat janë të gjurmueshme dhe të vërtetueshme, rezultuan të jenë kryer tërësisht nga subjekti, duke mos krijuar bindjen e trupit gjykues për besueshmërinë e pretendimeve dhe shpjegimeve të tij, se shumën e vendosura në depozitë derivojnë nga të ardhurat e prindërve të bashkëshortes.

12.15 Pavarësisht sa më sipër, në Kolegj u kontrollua analiza financiare e Komisionit, për verifikimin e mundësisë së vjehërrve të subjektit për të krijuar gjysmën e depozitës, në shumën prej 11.300 USD (1.564.118 lekë), e depozituar në Bankën Amerikane në vitet 2001 dhe 2002, nga e cila trupit gjykues i rezultoi se ata nuk kanë pasur mundësi të krijonin me burime financiare të ligjshme gjysmën e depozitës për një diferencë negative në shumën prej -1.414.536 lekësh. Pavarësisht vlerësimit si më sipër, me qëllim mospërkeqësimit të situatës së subjektit të rivlerësimit në Kolegj me ankimin e tij, trupi gjykues nuk i dha peshë pamundësisë financiare të vjehërrve për krijimin e gjysmës së depozitës, për arritjen e një konkluzioni të ndryshëm lidhur me pronarin dhe burimin e vërtetë të kësaj depozite.

Në përfundim, pavarësisht rrethanave të referuara më sipër, për veprimet e subjektit me këtë depozitë, në kuadër të parimit *no reformatio in peius*, për gjysmën e depozitës, të konsideruar nga Komisioni në pronësi të subjektit të rivlerësimit, në shumën prej 11.300 USD, të depozituar në Bankën Amerikane në vitet 2001 dhe 2002, nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se ka pasur burime financiare të ligjshme për të krijuar gjysmën e saj, për një diferencë negative në shumën prej - 453.053 lekësh [subjekti rezultoi me një balancë negative prej -179.880 lekësh për krijimin e shumës 7.500 USD / 1.027.800 lekë, të depozituar në Bankën Amerikane, më datë 15.07.2001, dhe me një balancë negative prej - 273.174 lekësh për krijimin e shumës 3.800 USD / 536.318 lekë, të depozituar në Bankën Amerikane më datë 26.09.2002], duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

13. Lidhur me përdorimin e apartamentit me sip. 67 m², nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti ka pretenduar se marrëdhënia juridike në momentin e krijimit të pasurisë ka qenë huapërdorje dhe ka zgjatur për një kohë të gjatë. Subjekti shpjegon se kontratën e furnizimit me energji elektrike dhe furnizimit me ujë, i ka lidhur vetë për arsye se pallati ishte në përfundim dhe vjehri i tij nuk kishte ardhur akoma të jetonte në Tiranë, ndaj në këtë apartament do të banonte vetë subjekti. Subjekti sqaroi se fillimisht ka banuar në apartamentin që vjehri i tij e ka blerë në vitin 1999, derisa u prenotua apartamenti tjetër në vitin 2003. Në lidhje me çmimin e parashikuar në kontratën e blerjes së nënshkruar nga z. M. K., subjekti sqaroi se të gjithë banorët i kanë prenotuar në vitin 2003, tek shoqëria “{***}” ShPK, por kontratat i kanë nënshkruar në vitet 2005, 2006, 2007 kur kanë hyrë në apartamente. Çmimi i kontratave ka qenë pothuajse i njëjtë, 320 euro për m² dhe për krahasim ka paraqitur kontrata të banorëve të këtij pallati. Subjekti gjithashtu sqaroi se, në kuptim të nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, nuk kishte detyrimin për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie nga vjehri, pasi fakti i lidhjes së mëvonshme të kontratës së dhurimit që shërben edhe si shkaku që e vendos një detyrim të tillë sipas ligjit, nuk duhet të çojë në hamendësime mbi konsiderimin e saj si pasuri e fshehur. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se vjehrit e tij nuk justifikojnë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 21.632 euro, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit.

13.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: “Në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes, trupi gjykues, duke mbetur në kuadër të dyshimeve të arsyeshme, nuk mund të konkludojë për fshehje pasurie nga ana e subjektit, por krijoi bindjen se subjekti, i cili është sjellë si pronar i apartamentit dy vite më parë se vjehri i tij ta blinte pasurinë e në vijim, ka kryer deklarime të

pasakta e të pamjaftueshme të kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi nuk arriti të vërtetojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Në analizën financiare të rishikuar, shuma e blerjes së pasurisë prej 21,632 eurosh, nuk është konsideruar si vlerë e paguar nga subjekti i rivlerësimit, duke mos ia atribuuar atij mungesën e burimeve të ligjshme të prindërve të bashkëshortes për të blerë pasurinë”.

13.2 Në deklaratën *vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar përfitimin e këtij apartamenti, me burim kontratën e dhurimit nga babai i saj.

13.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, ka rezultuar si vijon:

i) Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.01.2006, apartamenti objekt kontrolli është blerë nga z. M. K. (vjezhri i subjektit), kundrejt çmimit 21.632 euro, i likuiduar.

ii) Me kontratën⁹ e dhurimit datë 06.02.2014, kjo pasuri i është dhuruar bashkëshortes së subjektit, znj. M. N., nga babai i saj, z. M. K.

iii) Nëpërmjet kontratës së shitjes me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.02.2021, bashkëshortja e subjektit në cilësinë e shitëses, dhe Saimir Nazifi në cilësinë e dhënësit të pëlqimit, i shesin M. dhe A. Sh., këtë apartament kundrejt çmimit 9,268,500 lekë (ekuivalent i shumës 75,000 euro, shënuar në kontratë). Nëpërmjet deklaratës noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol, të datës 16.04.2021 subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar se është shlyer e plotë vlera e çmimit të apartamentit, ndërsa nëpërmjet deklaratës tjetër noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.09.2021 pala shitëse dhe blerëse kanë deklaruar se është bërë dorëzimi fizik i apartamentit, bashkë me çelësat e tij, si dhe kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike.

13.4 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga data 11.10.2003 – 30.08.2021 ka banuar pa pagesë në apartamentin në pronësi të vjezhrit, në adresën Njësia Administrative nr. {***}, rruga “{***}”, Tiranë, i cili më pas i është dhuruar bashkëshortes së subjektit.

Duke qenë se vjezhri i subjektit ka fituar pronësinë në vitin 2006, Komisioni pyeti subjektin në lidhje me legjitimitimin e tij për të banuar në këtë apartament që në vitin 2003. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se banimi i tij në apartamentin e vjezhrit ka filluar që nga data 11.10.2004 dhe jo 11.10.2003 (ka qenë një lapsus deklarimi në pyetësorin standard nga 2004 në 2003). Subjekti sqaron se, nga data 16.04.2003 (ditë kur u emërua avokat në Avokaturën e Shtetit) dhe deri më 11.10.2004, ka banuar në apartamentin tjetër në pronësi të vjezhrit të tij, i blerë në vitin 1999¹⁰. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit fotokopjen e kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.05.1999, ku aktualisht jeton vjezhra e subjektit, znj. L. K.

13.5 Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, ka pyetur subjektin e rivlerësimit për arsytet pse ai ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2004, ndërkohë që vjezhri i tij është bërë pronar i

⁹ Kontrata e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.02.2014.

¹⁰ Në adresën e deklaruar rruga “{***}”, Tiranë.

apartamentit në vitin 2006. Subjekti ka sqaruar se pallati ku ndodhet kjo pasuri ka mbaruar në vitin 2004, por leja e shfrytëzimit është marrë në vitin 2005. Menjëherë sapo është marrë leja e shfrytëzimit dhe pasuria është regjistruar më datë 19.09.2005 në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë në emër të shoqërisë, është lidhur kontrata e shitjes për kalimin e pronësisë së apartamentit nga shoqëria ndërtuese tek z. M. K., në vitin 2006. Subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje të aktit të kolaudimit të pallatit të datës 29.09.2004 dhe lejes së shfrytëzimit të datës 27.01.2005.

13.6 Komisioni kërkoi informacion në lidhje me kontratën e energjisë elektrike nr. {***} dhe kontratën e furnizimit me ujë nr. {***} (sipas librezave të paraqitura nga subjekti në pyetësonin standard), për të cilat FSHU¹¹ informoi se kontrata nr. {***}, me kod klienti {***}, i përket abonentit A. Sh. (blerësi i apartamentit në vitin 2021), kontratë e hapur më datë 09.10.2004 nga Saimir Nazifi.

Gjithashtu UKT informoi¹² se, për hapjen e kontratës me nr. {***} dhe nga kontrolli në arkivin e UKT Sh.A., disponojnë regjistër të kontraktuesve që prej vitit 2004, ku rezulton se kjo kontratë është regjistruar në emër të z. Saimir Nazifi, për objektin pallat me adresë rr. “{***}” (pallati ka hyrjen nga kjo rrugë). Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, në rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur në prapësimet e tij, duke sqaruar se: *“Kontratën e energjisë dhe të ujesjellësit i kam hapur, unë subjekti i vetting-ut, në vitin 2004, për arsyen e thjeshtë se pallati ishte në përfundim e sipër (përfundoi në shtator-tetor 2004). E hapa në emrin tim meqenëse z. K. nuk ishte akoma në Tiranë dhe në këtë apartament do banoja unë”*.

Komisioni hetoi edhe lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër informoi se subjekti, gjatë kohës që ka qenë gjyqtar pranë kësaj gjykate, nuk ka gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë ndërtuese “{***}” SHPK dhe administratorin e shoqërisë z. I. M..

13.7 Komisioni, nëpërmjet pyetësonit nr. 2, i ka kërkuar informacion subjektiv të rivlerësimit në lidhje me mënyrën si vjehri i tij ka likuiduar çmimin e blerjes së apartamentit, por ai nuk ka dhënë shpjegime apo paraqitur dokumentacion justifikues ligjor lidhur me sa u kërkua. Vetëm në prapësimet mbi rezultatet e hetimit paraprak, subjekti ka shpjeguar se, për shkak se z. M. K. ka ndërruar jetë, ai nuk ka asnjë informacion për mënyrën dhe periudhën e kryerjes së pagesave nga z. M. K. për këtë apartament, ashtu siç nuk ka edhe për blerjet e apartamenteve të tjera që vjehri i tij ka blerë në vitet 1999 dhe 2001.

Komisioni i është drejtuar me shkresë¹³ shoqërisë “{***}” SHPK, duke i kërkuar informacion se nga kush është kryer pagesa në shumën 21.632 euro për blerjen e apartamentit objekt kontrolli, si dhe të dorëzojë dokumentacion për likuidimin e kësaj shume. Në përgjigje, kjo shoqëri ka bashkëngjitur kontratën e shitjes të vitit 2006, ku çmimi i blerjes së apartamentit është 21.632 euro, i cili është likuiduar *cash* i ndarë në këste, por për shkak se kanë kaluar 18 vite, ka sqaruar se nuk disponojnë mandat pagesat.

¹¹ Shkresa nr. {***} prot, datë 08.05.2024, në dosjen e Komisionit.

¹² Shkresa nr. {***} prot, datë 21.05.2024.

¹³ Shkresë nr. {***} prot., datë 31.01.2024.

13.8 Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar fillimisht mundësinë e blerjes së apartamentit në rr. “{***}” nga vjehtërit e subjektit në vitin 2004. Në këtë analizë nuk ka përfshirë likuiditetet nga depozita dyemërore e subjektit me L. K., duke qenë se nuk u provua burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj depozite, dhe për këtë arsye analiza financiare është kryer e fragmentuar duke përfshirë vetëm të ardhurat e tyre nga data 26.09.2002 deri në vitin 2004. Nga kjo analizë, Komisioni i rezultoi se prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk kanë pasur mundësi financiare për të paguar çmimin e apartamentit, i cili është përdorur për banim nga subjekti i rivlerësimit, pasi kanë rezultuar me një balancë negative prej - 2,340,854 lekësh.

Në rezultatet e hetimit, Komisioni vlerësoi se çmimi i paguar për blerjen e pasurisë t’i konsiderohet si shpenzim i subjektit në vitin 2006 (referuar kontratës së shitjes), për shkak të konstatimeve si në vijim:

(i) Blerja e pasurisë nga vjehtëri i subjektit është bërë në vitin 2006, periudhë në të cilën ai ka pasur një apartament tjetër në Tiranë të blerë që në vitin 1999, ku ka banuar me bashkëshorten që kur janë transferuar nga Peshkopia në vitin 2004 dhe në vijim pas vdekjes së tij përdorur nga bashkëshortja, deri sot.

(ii) Sikurse subjekti deklaron, ai ka filluar të përdorë apartamentin që në vitin 2004 kur ka përfunduar ndërtimi i pallatit, ndërkohë që në datën 09.10.2004 është lidhur kontrata e energjisë elektrike në emër të tij, dhe në maj të vitit 2004 është lidhur kontrata e furnizimit me ujë në emër të tij. Në mënyrë të pa legjitimuar dhe të paqartë, subjekti ka përdorur pasurinë që nga viti 2004 kur kanë përfunduar punimet, pra dy vite më parë se të jetë lidhur kontrata e shitjes së pasurisë në emër të vjehtërit.

(iii) Subjekti ka përdorur pa ndërprerje dhe pa kundërshpërblim pasurinë që nga viti 2004 deri në vitin 2014 kur bashkëshortja e tij është bërë pronare me dhurim nga babai, dhe në vijim, deri në vitin 2021, kur e ka shitur pasurinë. Ndërsa vjehtërit e subjektit nuk e kanë përdorur asnjëherë pasurinë.

(iv) Në DPV 2004 e deri deklarimin për vitin 2013, subjekti nuk ka deklaruar të drejtën reale të përdorimit mbi këtë pasuri, ndonëse ka deklaruar adresën e banimit.

(v) Subjekti nuk ka qartësuar dhe vërtetuar në deklaratimet e tij gjatë procesit, mënyrën dhe periudhën kur është bërë likuidimi i çmimit të blerjes së këtij apartamenti nga vjehtëri i tij, dhe as mënyrën si e ka përdorur pasurinë që në vitin 2004.

(vi) Tërheqja nga subjekti e vlerës prej 23,307.54 USD, më 26.11.2004, nga llogaria dyemërore me vjehtërin, dhe për të cilën janë ngritur dyshime se mund të ketë qenë e subjektit të rivlerësimit, përkon me periudhën që vetë subjekti ka filluar të përdorë apartamentin, në vitin 2004, e në këto kushte, ngrihen dyshime që pagesa e këtij apartamenti mund të jetë kryer që në vitin 2004 nga subjekti, me vlerat monetare të depozitës bankare dyemërore me vjehtërin.

(vii) Prindërit e bashkëshortes nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të blerë pasurinë me çmimin 21,632 euro, i cili është sa ½ e çmimit referencë të EKB-së, duke u ngritur dyshime se çmimi i vendosur në kontratën e shitjes mund të jetë fiktiv.

Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime e të dorëzojë dokumente shkresore që të vërtetojë se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

13.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës për konstatimet¹⁴ e Komisionit, ka shpjeguar në mënyrë të përmbledhur si në vijim:

- *Z. M. ka pasur jo një apartament, por 2 apartamente të tjera kur ka prenotuar këtë apartament. Shtëpinë që do jetonte vetë kur do transferohej përfundimisht në Tiranë, ku jeton edhe sot e shoqja, L. K., që e kishte blerë që në vitin 1999 dhe shtëpinë në Allias që ia kishte dhënë në përdorim vajzës tjetër, N. K., për banim e klinikë, të cilën e kishte blerë që në vitin 2001.*

- *Në deklaratimet në ILKDPKI, unë, subjekti, kam theksuar gjithmonë që rri pa kundërshpërblim në këtë adresë (pronësi e M. K.).*

- *Unë, subjekti, nuk kam asnjë informacion për mënyrën dhe periudhën e kryerjes së pagesave nga ana e z. M. K. për këtë apartament. (siç nuk kam edhe për blerjet e apartamenteve të tjera që ai ka blerë në 1999 dhe 2001).*

- *Dyshimet e ngritura, se tërheqja e depozitës 23,307.54 USD, më 26.11.2004, nga llogaria dyemërore me vjehrrën është përdorur për pagesë për këtë apartament, nuk qëndrojnë, sepse është plotësisht e konfirmuar se me pjesë të kësaj shume, është kryer pagesa për prenotimin e apartamentit të blerë nga vjehrrri në plazh, Durrës. Pagesë e kryer vetëm 4 ditë më vonë.*

- *Çmimi i blerjes së apartamentit me sip. 67 m², rruga “{***}”, është në masën e deklaruar, 21.632 euro. Bashkëngjitur keni kontrata të ngjashme të lidhura në këtë ndërtesë. Këstet e apartamentit ishin dhënë gjatë vitit 2003.*

- *Dhurimi i të dy apartamenteve për 2 vajzat është kryer në vitin 2014. Kjo, siç duket, për arsye që të jetë konsistent dhe në rregull me të dy vajzat.*

13.10 Pas shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit, Komisioni, duke konsideruar edhe qëndrimin në vendimin e Kolegjit për subjektin e rivlerësimit F. I., çmoi se në vlerësimin përfundimtar të çështjes, pavarësisht dyshimeve, nuk mund të konkludojë për fshehje pasurie nga ana e subjektit, por krijoi bindjen se subjekti ka kryer deklaratime të pasakta e të pamjaftueshme për këtë pasuri, si dhe nuk konsideroi shumë e blerjes së apartamentit prej 21.632 eurosh, si të paguar nga subjekti i rivlerësimit, duke mos ia atribuuar atij mungesën e burimeve të ligjshme të prindërve të bashkëshortes për të blerë pasurinë.

13.11 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vjehrrit e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme për të blerë pasurinë, duke paraqitur disa dokumente shkresore, si deklaratë noteriale të shtetasit A. K., si dhe një pasqyrë llogarie bankare të BKT-së për pagesat që vjehrrit i tij ka përfituar nga një klinikë mjekësore, të cilat nga verifikimi i kryer në Kolegj, nuk përbëjnë të ardhura të tjera, të ndryshme nga ato të verifikuara e kontrolluara gjatë hetimit administrativ në Komision.

13.12 Në vlerësim të akteve të administruara në dosje, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përdorur apartamentin e vjehrrit të tij që nga viti 2004 deri në vitin 2014, vit në të cilin

¹⁴ Konstatimet në faqet 27 dhe 28 të vendimit të Komisionit.

bashkëshortja e tij është bërë pronare e këtij apartamenti nëpërmjet dhurimit të kryer nga babai i saj, i cili është shitur më pas në vitin 2021. Trupi gjykues konstaton se, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor për të provuar porositjen e kësaj pasurie dhe mënyrën e likuidimit të çmimit të saj. Nga aktet e administruara, rezulton vetëm një akt që provon formalizimin e marrëdhënies së vjehrrit të tij, z. M. K., me shoqërinë “{***}” SHPK për fitimin e pasurisë apartament, konkretisht kontrata e shitjes e vitit 2006. Subjekti, siç edhe është referuar më sipër në paragrafin 13.5, ka shpjeguar arsyet e vonesës sipas tij për nënshkrimin e kontratës së shitjes për kalimin e pronësisë së apartamentit nga shoqëria ndërtuese tek z. M. K., në vitin 2006. Subjekti ka vënë në dispozicion fotokopje të aktit të kolaudimit të pallatit në datën 29.09.2004 si dhe lejen e shfrytëzimit datë 27.01.2005.

Lidhur me dyshimet e ngritura nga Komisioni për çmimin në kontratën e shitjes, subjekti ka depozituar, bashkë me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, dy kontrata shitjeje¹⁵, të cilat i përkasin viteve 2005 dhe 2007, në të cilat pasqyrohet çmimi prej 320 euro/m². Subjekti ka pretenduar se pagesat e kësteve të çmimit të apartamentit janë dhënë gjatë vitit 2003, por ky pretendim i tij ka mbetur në nivel deklarativ, për sa kohë prej tij nuk u paraqit asnjë dokumentacion justifikues ligjor për të provuar sa pretendonte.

Trupi gjykues vëren se subjekti nuk e ka deklaruar asnjëherë në DIPP-të e viteve 2004 - 2013 marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur të tij me këtë pasuri, deklarimi i së cilës përveçse do t'i krijonte mundësi ILDKPKI-së për të verifikuar këtë fakt, do të përbënte provë në procesin e rivlerësimit [sipas neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016], e do të shërbente për krijimin e bindjes për marrëdhënien reale që ai ka pasur me këtë pasuri.

Sipas akteve të administruara në fashikull, rezulton se subjekti ka lidhur në emër të tij kontratën e furnizimit me energjisë elektrike dhe kontratën e furnizimit me ujë që në vitin 2004. Trupit gjykues i rezultoi se regjistrimi i këtyre kontratave në emër të subjekti është bërë dy vite para kalimit të pronësisë së apartamentit tek z. M. K. me kontratën e shitblerjes, madje edhe pa u marrë leja e shfrytëzimit si dhe regjistruar kjo pasuri në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të shoqërisë “{***}” SHPK. Pavarësisht shpjegimeve të përcjella nga subjekti për arsyet e lidhjes së këtyre kontratave në emër të tij, trupi gjykues i vlerëson ato jo bindëse, në konsideratë të faktit që vjehrrit e tij kanë blerë edhe një apartament tjetër në vitin 1999, kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të të cilit duket se nuk rezultojnë të kenë qenë në emër të subjektit, si dhe të faktit të deklaruar prej tij, që ata kanë ardhur për të banuar në Tiranë në vitin 2004, duke e pasur tërësisht të mundur lidhjen e këtyre kontratave në emër të vjehrrit. Sa i përket argumentit të subjektit, se kjo pasuri i është dhuruar bashkëshortes së tij, pasi vjehrrit e tij i kishin dhuruar një pasuri edhe vajzës tjetër, trupi gjykues konstaton se ky argument i dhënë prej tij gjatë prapësimeve në Komision, ka mbetur në nivel deklarativ dhe i pambështetur në akte/prova.

13.13 Trupi gjykues vëren se z. M. K. i ka dhuruar në vitin 2014 vajzës së tij (bashkëshortes së subjektit) apartamentin objekt kontrolli. Këtë apartament, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit

¹⁵ Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.12.2005, me blerës B. Gj., për blerje apartamenti me çmimin 320 euro/m²; kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.05.2007, me shitës shoqërinë e ndërtimit “{***}” SHPK dhe blerës E. M., për blerje apartamenti me çmimin 320 euro/m².

e ka deklaruar në deklaratën *vetting*, me burim kontratën e dhurimit nga babai i saj. Në nenin 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se për cilat marrëdhënie në fushën e interesit pasuror, ku përfshihet dhe marrëdhënia e dhurimit, subjekti i rivlerësimit, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur, kanë detyrimin për justifikuar me dokumentacion ligjor, burimet e krijimit të pasurisë objekt dhurimi. Në konsideratë të sa më sipër, në zbatim të nenit 3, pika 14, dhe nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, z. M. K. ka cilësinë e personit tjetër të lidhur, për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, kanë detyrimin të provojnë burimin e ligjshëm të pasurisë apartament objekt dhurimi prej tij.

Komisioni, në fund të hetimit administrativ, ka ngritur dyshime se pasuria objekt verifikimi ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe dhurimi nga babai tek vajza (bashkëshortja e subjektit) në vitin 2014 është kryer formalisht. Duke u nisur nga këto dyshime, Komisioni kreu analizën e mundësisë së prindërve të bashkëshortes së subjektit për të blerë apartamentin, duke e përlloritur si të blerë në vitin 2004, sipas metodologjisë së cituar në paragrafin 13.8, më sipër në këtë vendim. Komisioni përlloriti mundësinë financiare të vjehërrve të subjektit, edhe në versionin që çmimi konsiderohet se është paguar në vitin 2006, pra në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes, nga e cila rezultoi se ata kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën - 3,521,303 lekë, për të paguar blerjen e apartamentit në datën 04.01.2006.

13.14 Si edhe është referuar më sipër në vendim, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë që ai ka pasur në përdorim e më pas në pronësi të bashkëshortes, nëpërmjet dhurimit nga babai. Si subjekt i deklarimit të pasurisë sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), duhet të kishte treguar kujdes të shtuar, qoftë në periudhën e përdorimit të apartamentit, për të siguruar informacion dhe dokumentacion lidhur me mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie, apo edhe të ardhurat që i kanë shërbyer babait të bashkëshortes për blerjen e këtij apartamenti. Përveç sa më sipër, referuar neneve 30 dhe 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 18¹⁶ të Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin për deklarimin saktësisht dhe në mënyrë të plotë të pasurisë së tij dhe personave të lidhur, për burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra, shkaku apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj, detyrim të cilin subjekti nuk e ka përmbushur, situatë e cila e vendosi trupin gjykues në pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

13.15 Pavarësisht sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vëren se Komisioni, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, në kuadër të parashikimit të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, kishte detyrimin të analizonte dhe evidentonte saktë marrëdhënien juridike reale që ka lidhur subjektin e rivlerësimit me pasurinë e deklaruar në deklaratën *vetting* prej bashkëshortes së tij si

¹⁶“Nëse subjekti i rivlerësimit deklaron marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit, të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes së subjektit të rivlerësimit”.

pasuri dhuruar në vitin 2014, me qëllim verifikimin e çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të saj si një pasuri në përdorim në periudhën 2004-2014. Bazuar në analizën e vlerësimit të akteve dhe rrethanave si më sipër referuar në vendim, ashtu si për Komisionin edhe për trupin gjykues në Kolegj mbeti e dyshimtë sjellja në dukje si pronar e subjektit me këtë pasuri si dhe marrëdhënia reale që ai ka pasur me këtë pasuri, prej vitit 2004 deri në vitin 2014 kur ajo i është dhuruar bashkëshortes së tij nga vjehrrit.

13.16 Pavarësisht dyshimeve të referuara në paragrafin 13.13 të vendimit, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, në Kolegj u kontrollua analiza financiare e Komisionit, për të verifikuar mundësinë e prindërve të bashkëshortes së subjektit, për të paguar çmimin prej 21.632 eurosh për blerjen e apartamentit në vitin 2004. Trupi gjykues, ashtu si dhe Komisioni, konfirmon se ata kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën - 2.340.854 lekë.

Edhe pse në Kolegj u konfirmua mungesa e burimeve financiare të ligjshme të vjehërve për krijimin e pasurisë apartament objekt dhurimi, përsëri, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, shuma prej 21,632 eurosh [çmimi i blerjes së apartamentit], ashtu si në Komision, edhe në Kolegj nuk është konsideruar si e paguar nga subjekti i rivlerësimit, duke mos ia atribuar atij pasojën për mungesën e burimeve të ligjshme të prindërve të bashkëshortes për të blerë pasurinë.

13.17 Në përfundim të sa më sipër, lidhur me pasurinë objekt kontrolli, të fituar nga bashkëshortja e subjektit nëpërmjet kontratës së dhurimit të vitit 2014, në kuadër të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të justifikonte me burime financiare të ligjshme pasurinë e dhuruar, bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit 84/2016. Nga kontrolli në Kolegj i analizës financiare të Komisionit, rezultoi se konfirmohet mungesa e burimeve financiare të ligjshme e personave të tjerë të lidhur për financimin e kësaj pasurie. Si më sipër arsyetuar, rezulton se analiza, vlerësimi dhe konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë pasuri, është i paqartë, por pavarësisht këtij qëndrimi, edhe pse problematika e evidentuar lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për këtë pasuri nuk është kualifikuar sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, ajo u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues në drejtim të besueshmërisë së subjektit për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

14. *Lidhur me pasurinë automjet të markës Opel Astra*, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se ka pasur mundësi financiare për ta blerë atë në vitin 2011, dhe si burim për financimin e këtij mjetei kanë shërbyer të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Peshkopi në shumën 1.000.000 lekë. Subjekti sqaron se pamundësia e konstatuar nga Komisioni vjen si rrjedhojë e afektimit nga depozita dyemërore e përbashkët me vjehrrën e tij, si dhe mosllogaritja e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Peshkopi. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka bërë objekt të vendimmarrjes së tij deklaratën periodike vjetore, të cilën nuk ka pasur kompetencë dhe as juridiksion për ta bërë. Sipas subjektit, Komisioni duhet të kishte objekt të verifikimit vetëm deklaratën *vetting*, e cila sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ka për qëllim verifikimin e pasurisë dhe dokumenteve justifikuese. Sipas deklaratës *vetting*, burimet që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie janë të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit që subjekti kishte në qytetin e Peshkopisë.

14.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: “Subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në vlerën 5,500 euro, në vitin 2011, pasi nuk u provua që të ardhurat nga shitja e apartamentit në Peshkopi në vitin 2005 të ishin kursyer e më pas përdorur nga subjekti në vitin 2011 për blerjen e automjetit”.

14.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Automjet tip “Opel Astra”, prodhim i vitit 2003, me targë {***}, blerë në vlerën 5.500 euro, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 06.10.2011. Për blerjen e kësaj makine janë përdorur të ardhurat nga shitja e pronës, konkretisht e një dhome (apartament i katit të parë) me sipërfaqe prej 16 m² (e kthyer më pas në dyqan), ndodhur në Qytetin e Peshkopisë. Kjo dhomë u ble për shumën 200.000 lekë, sipas kontratës me nr. {***} rep., dhe {***} kol., dhe është shitur më datë 26.08.2005 për vlerën 1.000.000 lekë, me kontratën e shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol. Zotërues 100 %. Burimi i krijimit: nga shitja e pronës në Peshkopi”.

Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar se e ka blerë mjetin “Opel Astra”, për çmimin 5,500 euro, në datën 06.10.2011, dhe se burimi i të ardhurave kanë qenë të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

Në referencë të deklarimeve të mësipërme, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit është kontradiktor në deklaratimet e tij lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën vetting, ka deklaruar se burimi i të ardhurave është nga shitja e pronës që ka pasur në Peshkopi, ndërsa në DIPP-në e vitit 2011, ka deklaruar si burim të ardhurat nga paga e tij.

14.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se me kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.10.2011, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Opel Astra”, vit prodhimi 2003, në vlerën prej 5.500 eurosh.

Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se këtë mjet e ka shitur, në datën 06.09.2019, me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., kundrejt vlerës 1.600 euro, kontratë të cilën e ka dorëzuar në Komision.

Me qëllim verifikimin e faktit nëse nga subjekti ishin përfituar të ardhura nga shitja e pronës së blerë në qytetin e Peshkopisë, Komisioni kreu kontrollin, nga i cili rezultoi se sipas kontratës nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.02.2003, subjekti ka blerë një apartament, kundrejt çmimit 200.000 lekë, i përbërë nga një dhomë, ndodhur në lagjen “{***}”, në qytetin e Peshkopisë, me sip. 16.2 m². Sipas kontratës noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 26.08.2005, Saimir dhe M. N. e kanë shitur këtë apartament për çmimin 1.000.000 lekë, deklaruar shitja e saj në DPIP-në e vitit 2005. Komisioni ka konstatuar në kartelën e pasurisë, se për këtë apartament është paguar tatimi për të ardhurën e krijuar nga shitja e tij. Gjithashtu, Komisioni verifikoi vlerat e EKB-së për tregun e lirë,¹⁷ në vitet 2003 dhe 2005, nga të cilat rezultoi se çmimi i apartamentit ishte më i lartë (369,813.6 lekë) në vitin 2003 kur është bërë blerja, dhe më i ulët (386,289 lekë) se sa e ka shitur apartamentin në vitin 2005. Pavarësisht këtyre vlerave referente, të rezultuara më të larta apo të

¹⁷ Udhëzimi nr. 1, datë 08.05.2003, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit ‘K’”.

ulëta nga përlllogaritja e tyre sipas çmimeve të EKB-së, respektivisht në vitin e blerjes dhe shitjes së kësaj pasurie, Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka marrë në konsideratë çmimet sipas kontratave të referuara më sipër.

14.4 Me qëllim verifikimin e të ardhurave që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në qytetin e Peshkopisë në vitin 2003, Komisioni konstatoi se, në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit, të ardhurat e punës së tij dhe të prindërve, ndërsa në përgjigjet për pyetësorin standard të hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar si burim kursimet në vite të pagës së tij dhe bashkëshortes.

Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e blerjes me burime financiare të ligjshme të pasurisë apartament 16.2 m² blerë sipas kontratës 10.02.2003 në vlerën 200.000 lekë. Në këtë analizë financiare, janë konsideruar të ardhurat nga punësimi i subjektit, bashkëshortes dhe prindërve të tij, ndërsa shpenzimet jetike janë përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së. Nga kjo analizë, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, për periudhën nga viti 1991 deri në momentin e blerjes së apartamentit sipas kontratës datë 10.02.2003, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për një diferencë negative në shumën -2,563,238 lekë, për mbulimin e shpenzimeve dhe blerjen e apartamentit në Peshkopi.

14.5 Bazuar në deklaratën *vetting*, ku si burim i të ardhurave për blerjen e automjetit tip “Opel Astra”, janë deklaruar të ardhurat nga shitja e pronës në qytetin e Peshkopisë, pavarësisht mos justifikimit të blerjes së apartamentit me të ardhura të ligjshme, Komisioni verifikoi deklaratimet e interesave pasurore periodike të subjektit nga viti 2005, kur është bërë e shitja e apartamentit, deri në vitin 2011 ku deklarohet se këto të ardhura janë përdorur për blerjen e automjetit.

Në DIPP-të e viteve 2005 – 2009, vërehet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash*, ndërsa në vitet 2010 dhe 2011, ka deklaruar kursime respektivisht në shumat 700,000 lekë dhe 400,000 lekë, me burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Komisionit i rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar gjendje/shtesë *cash* në deklaratën e pasurisë për vitin 2005 kur është shitur pasuria apartament 16.2 m² në Peshkopi. Po ashtu, nuk rezultoi që të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie të jenë depozituar në llogaritë e tij bankare në vitin 2005 dhe as më vonë. Në këto kushte, Komisioni vlerësoi se të ardhurat nga shitja e pasurisë nuk mund të jenë përdorur në vitin 2011 për blerjen e automjetit.

14.6 Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me automjetin “Opel Astra”, Komisioni konstatoi se:

- *Ka mospërputhje të deklaratimit të burimit të krijimit pasi, në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar si burim “të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes” ndërsa në deklaratën vetting ka deklaruar si burim “të ardhurat nga shitja e apartamentit në Peshkopi”.*
- *Subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit në vlerën 5,500 euro, në vitin 2011.*
- *Ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën -2,563,238 lekë, për mbulimin e shpenzimeve dhe blerjen e apartamentit në Peshkopi.*

Për këto arsye, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjekti u ftua të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

14.7 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “Në lidhje me këtë konstatim, vlerësoj se ky vjen për faktin se është afektuar nga depozita e përbashkët me vjehrrën. Në tabelën tuaj të faqes 4 të raportit, duke hequr vlerën 3,106,069 lekë të depozitës, dhe duke shtuar tek të ardhurat pagat e bashkëshortes dhe ato të miat deri në vitin 1990 (natyrisht duke hequr shpenzimet) rezultati del me një mundësi kursimi 1,443,671 lekë”.

14.8 Bashkë me përgjigjet mbi rezultatet e hetimit, subjekti paraqiti edhe vërtetimin nr. {***} prot., datë 27.12.2016 të Bashkisë Dibër, sipas të cilit të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes për periudhën 01.04.1994 – 02.03.2003 janë në shumën 860.046 lekë. Në lidhje me pretendimin për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga paga e bashkëshortes për periudhën 1992 – 2003, Komisioni vlerësoi se ky pretendim është i drejtë dhe i mbështetur në prova dhe mori në konsideratë të ardhurat sipas vërtetimit më sipër, duke i përfshirë ato në analizën financiare, që ka gjetur pasqyrim në vendim.

14.9 Në analizë të akteve të administruara në dosje, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar si burim të blerjes së automjetit në vitin 2011 të ardhurat nga shitja e pasurisë në qytetin e Peshkopisë në vitin 2005. Ashtu si më sipër referuar në paragrafin 14.5, nga verifikimi i DIPP-ve për periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2009, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar kursime *cash*, të cilat mund të kishin pasur si burim shumën e përfituar nga shitja e kësaj pasurie. Gjithashtu trupi gjykues i rezultoi se në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar kursime të krijuara gjatë këtij viti në shumën 700.000 lekë, me burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, ndërsa në DIPP-në e vitit 2011, ka deklaruar kursime nga pagat gjatë vitit 2011, në shumën 400.000 lekë, me burime nga të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje, nuk rezulton se subjekti i rivlerësimit, shumën e përfituar nga shitja e pasurisë me sip. 16.2 m² në Peshkopi, ta ketë depozituar as në llogarinë e tij bankare.

14.10 Nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, për mundësinë e blerjes së pasurisë (një dhomë apartamenti) me sipërfaqe 16.2 m², ndodhur në Peshkopi, nga subjekti i rivlerësimit u konfirmua mungesa e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e saj në vlerën prej -412.285 lekësh.

Në konsideratë të sa më sipër referuar, për sa kohë nuk rezultoi e pasqyruar shuma prej 1.000.000 lekësh, si gjendje *cash* në deklaratat e interesave periodike pasurore, apo në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në qytetin e Peshkopisë, nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Opel Astra” në vitin 2011. Përveç sa më sipër, trupit gjykues nuk i rezultoi që gjatë viteve 2005 – 2009, subjekti i rivlerësimit të ketë krijuar kursime nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, që të mund të jenë përdorur si burim për blerjen e automjetit, edhe sipas versionit të burimeve të deklaruara prej tij

në DIPP-në e vitit 2011. Trupi gjykues, duke konsideruar edhe jurisprudencën¹⁸ e konsoliduar të Kolegjit, vlerëson se, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, në nenin 4, shkronja “d”, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve *cash* në banesë, jashtë sistemit bankar, pasi mosdeklarimi i tyre sjell pamundësinë e kryerjes së kontrollit dhe vlerësimit të kësaj situatë, sipas përcaktimeve në legjislationin e zbatueshëm në fuqi për rivlerësimin kalimtar, duke i lënë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në nivelin e deklarimeve, vërtetësia e të cilave mbetet e pamundur për t’u verifikuar. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar.

14.11 Në përfundim, trupi gjykues nuk konsideroi si burim të blerjes së pasurisë, kursimet e pretenduara nga subjekti si të krijuara për periudhën 2005 – 2009, të cilat nuk ishin deklaruar në DIPP të kësaj periudhe. Bazuar në këtë qëndrim, në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e automjetit “Opel Astra” në vitin 2011, në shumën - 310,065 lekë, për rrjedhojë trupi gjykues vlerësoi se ai gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

15. Lidhur me deklarin e gjendjes *cash*, në vitin 2016, në shumën 1.450.000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se prej tij nuk është kuptuar që gjendja *cash* duhet deklaruar periodikisht për sa kohë subjekti ka deklaruar çdo vit të ardhurat e përfituara prej tij dhe personave të lidhur me të. Subjekti shpjegon se, për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur burimit të krijimit të pasurisë në deklaratën e interesave periodike pasurore të vitit 2011, pasi ka kuptuar që ky burim është në seksionin e të ardhurave të kësaj deklarate, dhe për shkak të harresës, ka vendosur si burim në mënyrë të përgjithshme të ardhurat e përfituara nga ai dhe bashkëshortja e tij. Sipas pretendimit të subjektit në ankim, Komisioni, megjithëse ka pranuar gjendjen e likuiditeteve *cash* në vitin 2015 në masën 1.700.000 lekë sipas procesverbalit të ILDKPKI-së, në analizën e rishikuar financiare i ka kryer llogaritjet për gjendjen e likuiditeteve *cash* në vitet 2010 – 2014, duke u mbështetur në deklarinet e deklaratave periodike, me rezultat negativ në shumën - 1.650.000 lekë. Sipas subjektit, balanca negative totale për të gjithë periudhën e rivlerësimit duhet të jetë në shumën - 448.174 lekë.

Gjithashtu subjekti pretendon që shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në funksion të sqarimit të pasaktësive në plotësimin e deklaratave periodike, nuk mund të konsiderohen inekzistente, aq më tepër për shkak se janë krijuar shumë kohë përpara dhe jashtë kontekstit të procesit të rivlerësimit, ndaj u duhet dhënë kredibiliteti i nevojshëm për t’u përdorur në analizën që trupa gjyquese vlerëson të bëjë për sasinë e likuiditeteve *cash* në banesë.

15.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë çështje: “Në përfundim, në analizën financiare të rishikuar, Komisioni pasqyroj gjendjen *cash* sipas deklarinëve periodike ndër vite, me përjashtim

¹⁸ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 20/2020 (JR), datë 08.09.2020; vendimi nr. 47/2022 (JR), datë 14.12.2022; vendimi nr. 24/2024 (JR), datë 04.07.2022.

të vitit 2015 ku likuiditeti në cash është konsideruar në vlerën 1,700,000 lekë, sipas procesverbalit të datës 20.06.2016”.

15.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Disponoj në banesë shumë cash prej 1.450.000 lekësh, të përfituara nga kursimet nga pagat në vite të miat dhe të bashkëshortes. Zotërues 50 %. Burimi i krijimit: nga kursimet e pagave në vite të tij dhe bashkëshortes”.

- Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti deklaroi: “Kam kursyer gjatë vitit 2010 shumë prej 700,000 lekë. Kjo shumë është përfitur nga paga ime dhe e bashkëshortes”.

- Në DIPP-në e vitit 2011, ka deklaruar: “Është kursyer nga pagat gjatë vitit 2011, shuma 400,000 lekë”.

- Në DIPP-në e vitit 2012, ka deklaruar: “Është kursyer nga pagat gjatë vitit 2012, shuma 700,000 lekë”.

- Në DIPP-në e vitit 2013, ka deklaruar: “Kursime nga pagat për vitin 2013, shuma 700,000 lekë”.

- Në DIPP-në e vitit 2014, deklaroi: “Kursime nga pagat për vitin 2014, shuma 850,000 lekë”.

- Në DIPP-në e vitit 2015, deklaroi: “Kursime nga pagat për vitin 2015, shuma 700,000 lekë”.

- Në DIPP-në e vitit 2016 deklaroi: “Kursime nga pagat për vitin 2015, shuma 300,000 lekë”.

Nga leximi i deklaratave periodike, rezulton se gjendja e likuiditeteve cash në datën 31.12.2016 është në shumën 4.350.000 lekë, ndërsa gjendja e deklaruar në deklaratën vetting, në datën 30.01.2017, është 1.450.000 lekë.

- Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: “Shtuar në llogarinë Raiffeisen Bank shumë 550,000 lekë, krijuar nga kursimet e mbajtura në shtëpi ndër vite (të deklaruara në deklaratat përkatëse ndër vite). Shumë e depozituar me kontratë depozite me afat në janar të vitit 2017”.

Gjithashtu subjekti ka deklaruar edhe: “Pakësim të kursimeve në shumën 550,000 lekë, të mbajtura në shtëpi ndër vite (të deklaruara në deklaratat përkatëse), kaluar në llogarinë bankare”.

15.3 Sa i përket ligjshmërisë së kursimeve, Komisioni ka kryer analizën financiare për të gjithë periudhën e hetimit, ku rezultuan me balancë negative vitet 2011, 2013 – 2015, për të cilat iu kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës, duke evidentuar se deklarimi i subjektit në lidhje me gjendjen e likuiditetit cash në deklaratën vetting nuk përputhet me gjendjen cash të deklaruar në deklaratat periodike. Për këtë, Komisioni i kërkoi subjektit të vërtetojë se nuk ndodhet në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke dhënë sqarime në lidhje me destinacionin e përdorimit të shumës 2.350.000 lekë (4.350.000 lekë - 550.000 lekë - 1.450.000 lekë).

15.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti sqaroi si në vijim:

“1. Deklarimet në vite nga ana ime për tepricën janë kryer me logjikën e të ardhurave dhe shpenzimeve brenda një viti. Asnjëherë nuk është deklaruar shuma total cash në shtëpi, sepse nuk kërkohej deri me ndryshimet ligjore të vitit 2014. Pas këtyre ndryshimeve të vitit 2014, në deklarimin e vitit 2016, për gjendjen cash më 31.12.2016, kisha detyrimin për të deklaruar totalin e shumës cash, të cilën e bëra në deklaratën vetting, në janar 2017.

2. Në deklaratën vetting 2017, kam deklaruar ‘shtuar në llogarinë depozitë Raiffeisen Bank shuma 550.000 lekë. Ky depozitim u bë për shkak të kalimit të limitit të mbajtjes në shtëpi të kursimeve cash, të parashikuar nga neni 4/1 i ligjit 9049/2003’.
3. Në procesverbalin e datës 20 qershor 2016, me inspektorët e ILDKPI-së kam deklaruar se “gjendja e cash-it në shtëpi është 1.700.000 lekë”.
4. Me kursimet e vitit 2016 prej 300,000 lekësh, meqenëse shuma tashmë kishte tejkaluar vlerën e lejuar nga ligji, (sasia e likuiditetit cash në shtëpi, të pashpenzuar nga ana ime shkoi në shumën prej 2.000.000 lekësh,) atëherë në janar të vitit 2017 u depozituan në bankë 550.000 lekë dhe 1.450.000 u mbajtën në shtëpi gjendje kesh.
5. Diferenca me totalin që llogarit raporti financiar duke kryer mbledhje mekanike në vite është shpenzuar për shpenzime, për të cilat nuk janë deklaruar arsyet e ndryshme, sepse nuk ishin në shumën mbi 500.000 lekë deri në 2014 dhe 300.000 lekë në ndryshimet e vitit 2014 për të cilat kërkohej deklarim. (p.sh. pushime, ndihmë prindërve etj.).
6. Llogaritjet e gjendjes cash në shtëpi janë ato të procesverbalit në ILDKPKI dhe deklaratën vetting”.

15.5 Bashkë me parashtrimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision fotokopje të procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI më datë 20.06.2016, sipas të cilit subjekti është pyetur në lidhje me gjendjen *cash* në datën 31.12.2015, dhe në përgjigje ai ka deklaruar shumën prej 1,700,000 lekësh. Pavarësisht problematikave për anën formale të dokumentit, në një qëndrim garantist ndaj subjektit, Komisioni vlerësoi të mirëqenë faktin se ky procesverbal është përpiluar me kërkesë të ILDKPKI-së, dhe se gjendja e likuiditetit *cash*, në datën 31.12.2015, ka qenë në vlerën 1,700,000 lekë [siç edhe ai ka deklaruar në këtë procesverbal], që është në të njëjtën vijë logjike me ndryshimet e ndodhura në DIPP-në e vitit 2016 deri në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting* në datën 30.01.2017, ku gjendja *cash* e deklaruar është 1,450,000 lekë.

15.6 Në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje dhe vlerësim të sa më sipër është referuar, trupi gjykues analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike, në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003 dhe situatës faktike konkrete. Sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht, si dhe burimin e krijimit të saj. Në deklaratat periodike të viteve 2010 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime, por pa specifikuar llojin e këtij kursimi (*cash* në banesë apo likuiditet). Në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, sipas përgjigjeve në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, sipas së cilave ka sqaruar se *deklarimet për tepricën janë kryer me logjikën e të ardhurave dhe shpenzimeve brenda një viti, dhe asnjëherë nuk është deklaruar gjendja e likuiditeteve cash në shtëpi, sepse nuk kërkohej deri me ndryshimet ligjore të vitit 2014*, është një situatë faktike, e cila vështirëson kontrollin e rrjedhjes së këtij likuiditeti ndër vite, duke devijuar edhe analizën financiare me alternativa të ndryshme. Ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë, përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre, dhe jo të zgjedhë mënyra të personalizuar për të zbatuar këtë detyrim ligjor. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet

respektuar. Për më tepër, në nenin 4, germa “d” të ligjit nr. 9049/2003 (varianti fillestar / i pandryshuar) parashikohet që subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen *cash* në banesë, duke mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e pasurisë së tij.

15.7 Nga kontrolli që ushtroi Kolegji ndaj analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti ka deklaruar ndër vite kursimet e krijuara nga pagat, por në asnjë vit nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve gjendje *cash* apo pasuri të krijuara nga gjendja *cash* në banesë. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, deklaramet periodike vjetore janë forma e vetme zyrtare për të provuar shtimin dhe pakësimin e gjendjeve *cash*, si rrjedhojë, në mungesë të deklaramet të këtij pakësimi, pretendimi i subjektit për pakësimin e gjendjes *cash* me 1.650.000 lekë, në analizën e viteve 2010 – 2014, nuk mund të qëndrojë, pasi ai vetë nuk e ka deklaruar ndër vite një pakësim të tillë. Në analizën e kontrolluar në Kolegji, gjendja e kursimeve *cash*, për vitet 2010 – 2014, është pasqyruar njësoj si Komisioni, sipas deklarameteve periodike në vite, ndërsa në vitin 2015, likuiditeti *cash* është konsideruar në shumën 1.700.000 lekë, sipas deklarameteve të subjektit të rivlerësimit në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 20.06.2016.

15.8 Lidhur me analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, dhe efektin që ka në të depozita dyemërore [krijuar në vitin 2001 dhe mbyllur në vitin 2004], si dhe gjendja e *cash*-it si më sipër shqyrtuar, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet, për diferencën negative në shumën - 2.067.999 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

16. Krahas qëndrimeve të mësipërme, trupi gjykues në vlerësimin e kriterit të pasurisë, mbajti në konsideratë edhe konkluzionet e Komisionit lidhur me pasurinë, automjet të markës “Toyota Yaris”, për të cilën Komisioni në vendim ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme në shumën 232,979 lekë për blerjen e tij. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shkaqe ankimore lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, për rrjedhojë, diferenca negative, e referuar më sipër, mbetet e konfirmuar edhe në Kolegji.
17. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Saimir Nazifi gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka bërë deklaramet të pamjaftueshëm të pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e për rrjedhojë, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, germa “a” e po këtij ligji. Për pasojë, vendimi nr. 777, datë 25.06.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE:

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 777, datë 25.06.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Saimir Nazifi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall sot, më datë 18.02.2026, në Tiranë.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi